




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.56/2024

Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 11, paragrafi 3, të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet ankesa e z. Blerim Beshtica, gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjilan, kundër Planit të Punës të Gjykatës Themelore Gjilan për vitin 2024.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar nga z. Blerim Beshtica - Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, ankesën Nr.01/39, të datës 24.01.2024, kundër Planit të Punës së Gjykatës Themelore në Gjilan, për vitin 2024, gjegjësisht kundër caktimit/transferimit të tij nga Gjykata Themelore në Gjilan, në Gjykatën Themelore në Gjilan - Dega në Viti, me pretendimet se kjo kompetencë nuk i takon kryetarit të gjykatës, por është kompetencë e KGJK-së, në bazë të legjislacionit në fuqi, duke theksuar edhe çështjen e diskriminimit dhe rrethanat familjare.

Në takimin 321-të të Këshillit, u shqyrtua ankesa e gjyqtarit z. Blerim Beshtica dhe provat e bashkangjitura, ku në rastin konkret është vlerësuar se kemi të bëjmë me caktim apo transferim nga Gjykata Themelore në Gjilan, në degën e Vitisë, e cila hynë në kuadër të territorit të Gjykatës Themelore në Gjilan duke u bazuar në Ligjin për Gjykatat, si dhe i përgjigjet nivelit të kushteve të veçanta për gjyqtarë, sepse i njëjti caktohet apo transferohet nga Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil i Gjykatës Themelore në Gjilan, në po të njëjtin departament-divizion të degës në Viti.

Sa i përket pretendimeve të gjyqtarit se transferimi është kompetencë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të njëjtat nuk qëndrojnë, sepse Këshilli në bazë të Rregullores për Transfer është përgjegjës për lëvizjen e gjyqtarëve nga një gjykatë apo degë, në gjykatën apo degën tjetër, që nuk hynë brenda të njëjtit juridiksion territorial, kurse në rastin konkret kjo përgjegjësi është kompetencë ekskluzive e Kryetarit të Gjykatës.

Po ashtu, me vet faktin e miratimit të Planit të Punës së Gjykatës Themelore në Gjilan, për vitin 2024, është konsumuar kjo çështje, ngase KGJK e ka vlerësuar si të arsyeshme lëvizjen e gjyqtarit, pasi që në rastin konkret është në diskrecion të Kryetarit të Gjykatës që varësisht prej nevojave të gjykatës, përkatësisht vlerësimit të gjendjes së ngarkesës më lëndë, të caktoj gjyqtarët në degë, mirëpo me kusht që pas përmirësimit të gjendjes me lëndë në degën përkatëse, gjyqtari Beshtica, të kthehet përsëri në selinë kryesore të gjykatës.

Nga sa u tha më lartë, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Blerim Beshica;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore Gjilan;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Arkivit të KGJK-së.